



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1110/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkelzen Xhaferi kandidat për asamble kuvendit komunale nga subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Vushtrri, paraqitur kundër komisionerit Mensur Kuçi, për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Shkelzen Xhaferi kandidat për kuvendin komunal në Vushtrri nga radhët e subjektit politik LDK.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Shkelzen Xhaferi anëtarë për asamble komunale nga subjekti politik LDK dega në Vushtrri, i cili konsideron se ju janë marrë votat nga komisioneri i partisë së tij në sallën 2727B/01R në fshatin Shtruer në komunën e Vushtrri, andaj kërkon që të bëhet rinumrimin i votave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkesat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Shkelzen Xhaferi nga komuna e Vushtrrisë PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 1110/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.